

LIGJI

PËR PRISHTINËN, TRI VITE PAS MIRATIMIT

Niveli i zbatimit dhe efektet e arritura



Ligji

për Prishtinën,
tri vite pas miratimit

(Niveli i zbatimit dhe efektet e arritura)

Ky raport është përgatitur nga RECURA Financials për projektin DEMOS,
i cili zbatohet nga HELVETAS Swiss Intercooperation

Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht
qëndrimet e donatorëve dhe HELVETAS Swiss Intercooperation.

©DEMOS

Publikuar: Nëntor 2021

Prishtinë, Kosovë

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. HYRJE	7
2.1. Objekt i studimit	8
2.2. Metodologjia dhe objektivi i hulumtimit	8
3. INFORMATA PARAPRAKE	9
4. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E VEÇANTA TË KRYEQYTETIT	11
4.1. Simbolet e Kryeqytetit	11
4.2. Siguria publike e Kryeqytetit	12
4.3. Shërbimet e kujdesit dytësor shëndetësor	14
4.4. Shërbimet publike	15
4.5. Prona e Kryeqytetit	16
4.6. Nënkryetarët e Kryeqytetit dhe stafi mbështetës	17
4.7. Taksa shtesë	17
4.8. Shërbimi i Kuvendit të Kryeqytetit	17
4.9. Dekoncentrimi i shërbimeve administrative	18
4.10. Financimi i Kryeqytetit	18
5. PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE TË RREGULLIMIT TË STATUSIT TË KRYEQYTETIT	23
5.1. Qyteti i Bratislavës	23
5.2. Qyteti i Shkupit	24
5.3. Bashkia e Tiranës	25
6. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIMET	27
7. Bibliografia	29

1

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rregullimi i statusit të kryeqytetit me ligj të veçantë është objektivë e shumë shteteve, me qëllim të përcaktimit të një statusi më të veçantë në raport me qytetet tjera. Posaqërisht, shtetet evropiane i kanë dhënë një rëndësi rregullimit të statusit të kryeqytit (Gjermania, Sllovakia, Kroacia, etj¹). Është e evidentë që shumica e popullatës është e koncentruar të jetoj në kryeqytete. Terri-tori i kryeqyteti është më i madh, zhvillimi ekonomik, shërbimet diplomatike dhe elemente tjera të rëndësishme zhvillohen kryesisht në kryeqytete. Për këto arsye, me ligje të veçantë shtetet kanë përcaktuar status të ndryshëm nga ato të qyteteve të tjera në mënyrë që të decentralizojnë shërbimet dhe të themelojnë mekanizma të ndryshëm të cilët mirren me ofrimin e këtyre shërbi-meve, të ngrisin buxhetin për zbatimin sa më të mirë të përgjegjësive që dalin nga ligjet e tilla etj.

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe adoptimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, edhe Kosova e përcaktoi si obligim Kushtetues që Prishtina si Kryeqytet të ketë një ligj të veçantë që i jap një status të veçantë dhe me të cilin rregullohen aspekte të ndryshme në ofrimin e shër-bimeve për qytetarë dhe që e dallojnë nga rregullimi i tyre me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Një ligj i tillë është miratuar në vitin 2018, mirëpo edhe pas tri viteve të hyrjes në fuqi, ende ekzistojne disa sfida në zbatimin e tij të mirëfilltë dhe të cilat do të paraqiten në këtë raport në mënyrë që t'i analizojmë dhe të arrijmë në disa përfundime dhe rekomandime:

- **Mungesa e zbatimit adekuat të dispozitave ligjore.** Përkundër faktit se Ligji për Kryeqyte-tin e Republikës së Kosovës përcakton se kryeqyteti duhet të ketë stemën, vulën, emblem-ën dhe flamurin e vet, ende nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë nga Kuvendi i Komunës së Kryeqytetit të Prishtinës dhe organeve të saj për harmonizimin e këtyre simboleve. Pr-ishtina ende ka në fuqi Statutin e vitit 2010 i cili është i bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, por nuk ka pasur ndonjë iniciativë për të ndryshuar dhe adresuar ndonjë nga çësht-jet që adresohen me Ligjin për Kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën. Në të gjitha aktet dhe emërtimet e saj referohet si Komuna e Prishtinës, e jo kryeqyteti i Prishtinës.

¹ The Congress of Local and Regional Authorities. Chamber of local authorities. Status of capital cities, 2007. Burim: <https://rm.coe.int/status-of-capital-cities/16807199af>

- **Mungesa e themelimit të organeve të përcaktuara me ligj.** Ligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës i jep mandat Kuvendit të Komunës së Kryeqytetit të Prishtinës të themeloje Drejtorinë e Policisë, mirëpo ende nuk ka një organ të tillë. E njëjta situatë qëndron edhe me ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, me ç’rast përcaktohet mundësia që Prishtina të ketë një spital të vetin. Si pasojë e mungesës së koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe vullnetit politik, asnjëra nga këto dy këto institucione nuk është themeluar.
- **Paqartësia e dipozitave ligjore lidhur me regjistrimin e pronave të komunës së Prishtinës versus pronave të Kryeqytetit.** Prishtina përveq në rastin e pronës “Germia” dhe prona e fabrikës ‘IMN Kosova’ (ish “Cigllana”) nuk ka bërë ndonjë ndryshim në regjistrat kadastral lidhur me ndërrimin e titullarit të pronës, nga ajo e komunës në pronësi të kryeqytetit. Kjo për shkak të paqartësive ligjore lidhur me faktin se cili është dallimi dhe çfarë duhet të regjistrohet si pronë komunale dhe si pronë e Kryeqytetit.
- **Pamundësia e shfrytëzimit të grantit prej 6%.** Me Ligjin për Kryeqytetin, Prishtina përfiton një grant jo më pak se 6% me qëllim të zbatimit të përgjegjësive shtesë që i takojnë me këtë Ligj. Nga pamundësia që kompetencat e dhëna me këtë Ligj nuk janë zbatuar tërësisht, ky grant bartet nga viti në vit.
- **Mos-nxjerrja e akteve përkatëse për zbatim të ligjit.** Ministria përgjegjëse për punët e brendshme ende nuk ka nxjerrë një akt nën ligjor me të cilin përcaktohet se si do të rregullohet statusi i Drejtorisë së Policisë për Kryeqytetin. Një gjë të tillë nuk e ka bërë as MAPL lidhur me llojin e përcaktimit të tasksës shtesë të Kryeqytetit. Këto dy elemente kanë bërë që të mbetet i pazbatueshëm Ligji në këto dy fusha.
- **Mungesa e monitorimit të zbatimit të Ligjit.** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si përgjegjëse për monitorimin e funksionimit të komunave, deri më tani nuk ka bërë ndonjë monitorim specifik lidhur me zbatimin e Ligjit për Prishtinën. Monitorimi kryesisht është bërë duke marrë për bazë kompetencat e komunave të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, por kompetencat shtesë të përcaktuara me Ligjin për Prishtinën nuk janë monitoruar. Monitorimin e zbatimit të këtij ligji nuk e ka bërë as Kuvendi si institucioni më i lartë legjislativ në vend.

2

HYRJJE

Inicijativat për t'u bërë Prishtina me Ligj kanë nisur nga viti 2009 dhe kjo përpjekje buronte nga e drejta kushtetuese e vendit e cila përcakton se Kryeqytet i Kosovës është Prishtina dhe pozita e saj duhet të rregullohet me Ligj (neni 13). Që nga ajo periudhë deri në gjysmën e vitit 2018 janë shfaqur vështirësi dhe paqartësi lidhur me përmbajtjen që duhet të ketë Ligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës – Prishtina (këtu e tutje Ligji për Kryeqytetin).

Drafte të ndryshme të këtij Ligji janë përcjellur nga viti në vit, disa prej të cilave kanë kaluar edhe në procedurat parlamentare. Madje njëri nga këto drafte ka marrur miratimin në parim gjatë një seance të Kuvendit të Kosovës të mbajtur në korrik të 2011, por që më pas Komisioni Parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, këtë draft e ka kthyer në procedurë në qeveri me arsyetimin se përmbajtja aktuale e këtij Projektligji i referohet në tërësi komunës së Prishtinës dhe jo Kryeqytetit.

Komisioni parlamentar në atë kohë duke ju referuar një pune të ekspertizës ligjore, kishte rekomanduar që Kushtetuta e Kosovës kërkon miratimin e një Ligji për qytetin e Prishtinës dhe jo për Komunën e Prishtinës dhe poashtu kishte kërkuar sqarime shtesë nga ekzekutivi lidhur me Pallatin e Rinisë që në atë kohë ishte pjesë e Projektligjit dhe me të cilin përcaktohej transferimi i të drejtës së pronësisë, nga menaxhimi i Agjencionit Kosovar të Privatizimit në pronësi të Komunës së Prishtinës. Ky komision kundërshtonte formulimin në ligj për “Prishtinën metropolitane” e cila përcaktonte zgjerimin e territorit të Komunës së Prishtinës në dëm të komunave Obiliq, Lipjan, Podujevë dhe Fushë Kosovë, e cila binte ndesh me ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave të Kosovës. Në anën tjetër, ky draft nuk përcaktonte kufijtë e komunave tjera të sipërpërmendura, dhe komisioni kishte konstatuar se ky formulim është bërë pa u konsultuar dhe pa u pajtuar me komunat e tjera përkatëse.

Nga ajo kohë deri në fillim të vitit 2018 në Kuvend të Kosovës nuk është proceduar më asnjë draft i këtij Projektligji, duke e shndërruar kështu këtë vonesë në pretekst për akuza dhe kundër akuza mes partive politike. Në këtë situatë, në opinion janë krijuar pritje që miratimi i një Ligji për Prishtinën do të nënkuptonte zgjidhjen e gjitha problemeve me të cilat përballej Kryeqyteti.

Ligji për Prishtinën është miratuar në korrik të 2018 në Kuvend të Kosovës. Ky Ligj ka gjithësejt 21 nene. Qëllimi i këtij ligji përkufizohet në nenin e parë, ku thuhet se më këtë ligj rregullohet

organizimi dhe funksionimi i Kryeqytetit të Kosovës, i cili ka status të veçantë juridik. Territori i Kryeqytetit është i njëjtë me territorin e Komunës së Prishtinës, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave (03/L-041). Kryeqyteti është njësi e vetëqeverisjes lokale me status dhe organizim të veçantë, i cili ushtron kompetenca brenda territorit të tij.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale aplikohet edhe për Kryeqytetin, përveç nëse përcaktohet ndryshe me Ligjin për Kryeqytetin. Ligji për Kryeqytetin i jep Prishtinës të drejtën për të pasur brenda policisë së Kosovës një drejtori të veçantë për kryeqytetin dhe ka kompetenca për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor. Poashtu, Kryeqyteti sipas nevojës themelon dhe menaxhon ndërmarrje publike lokale që shërbejnë vetëm për territorin e Kryeqytetit. Kryetari i Kryeqytetit ka dy nënkryetarë të cilët e ndihmojnë Kryetarin në ushtrimin e kompetencave të tij, të cilët i emëron dhe i shkarkon Kryetari. Kryetari mund të emëroj deri në pesë këshilltarë. Prona e luajtshme dhe e paluajtshme që është në pronësi të Komunës së Prishtinës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, regjistrohet në pronësi të Kryeqytetit. Kryeqytetit i jepet një grant shtesë në lartësinë jo më pak se gjashtë përqind e grantit të përgjithshëm të komunave, të përcaktuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, nga buxheti i Kosovës për secilin vit fiskal.

2.1. Objekt i studimit

Duke qenë se Projekti DEMOS është projekt i qeverisjes lokale dhe në fazën hartimit të Ligjit për Kryeqytetin ka ndihmuar procesin e hartimit të këtij Ligji, në planin e vet për vitin 2021 ka planifikuar që të bëjë një studim lidhur me nivelin e zbatimit të këtij Ligji. Andaj, objektiva kryesore e këtij hulumtimi është të rishikojë dhe analizojë nivelin e zbatimit të Ligjit për Kryeqytetin, tri vite pas miratimit të tij.

2.2. Metodologjia dhe objektivi i hulumtimit

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur metodat kuantitative të nxjerrjes së rezultateve. Përveç Ligjit për Kryeqytetin, janë analizuar edhe përmbajtja e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Zgjedhjet Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit për Policinë, Ligjit për Shëndetësinë, Ligjin për Rendin dhe Sigurinë Publike, Ligjit për Obiliqin, Ligjit për fshatin Hoqë e Madhe, Ligjit për fshatin Zym i Hasit, Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Rregulloren për Themelimin e Ndërmarrjeve Publike/lokale, Korniza Afatmesme e Buxhetit 2020-2020 e Ministrisë së Financave dhe poashtu janë analizuar trendet buxhetore në nivel lokal nga vitit 2017 deri në vitin 2021 si dhe Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025.

Për sigurinë e të dhënave dhe konfirmimin e tyre është ndjekur metoda kualitative. Janë zhvilluar intervista me udhëheqës të Komunës së Prishtinës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Komunës së Obiliqit, Doganave të Kosovës, Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe janë intervistuar përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile. Përveç metodës kualitative dhe kuantitative të ndjekur për të nxjerr rezultatet, është përdorur edhe metoda krahasuese mes Ligjeve, rasteve dhe komunave dhe poashtu është bërë një analizë e rregullimit të statusit të kryeqyteteve të tjera rajonale dhe evropiane. Kjo me qëllim që të bëhet një krahasim i asaj se çfarë kompetenca kanë kryeqytetet tjera në krahasim me Kryeqytetin e Kosovës.

3

INFORMATA PARAPRAKE

Me një territor prej 572 km² dhe me një numër të popullsisë prej 198.897³, Prishtina është komuna më e madhe në Republikën e Kosovës. Statusi i saj si Kryeqytet i Kosovës përcaktohet më Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për kufijtë administrativ të komunave, Prishtina ka 42 fshatra (Ligji nr. 03/L-041). Për funksionimin e komunës përveç organeve qendrore funksionojnë edhe bashkësitë lokale.

Prishtina cilësohet si komuna më e madhe për veprimtari prodhuese, ndërtimore, hoteliere, tregtare etj. Vetëm në vitin 2020 janë regjistruar 2960 biznese prej të cilave dominojnë ato të tregtisë (715), duke pasuar edhe nga ato të aktiviteteve profesionale (493), komunikim dhe informim (349), etj⁴. Kjo komunë ende mbetet qendër e shërbimeve diplomatike dhe konsulore, si dhe qendër e shumë aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Prishtina si edhe komunat tjera, qeveriset sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi i Komunës i është organi më i lartë i komunës dhe përbëhet nga 51 anëtarë. Ndësa Kryetari i Komunës është organi më i lartë ekzekutiv. Këto organe zgjedhen në zgjedhje të lira dhe të drejtpërdrejta. Kuvendi i Komunës ka mandat të miratojë statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës, etj. Ndërsa Kryetari i Komunës ka përgjegjësi të a) përfaqësojë komunën dhe të veprojë në emër të saj; b) udhëheqë ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës; c) ushtrijë të gjitha kompetencat të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite kuvendit të komunës apo komiteteve të tij; d) ekzekutojë aktet e kuvendit të komunës, etj. Administrata e komunës kryen funksionet e përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale⁵, i cili ka për bazë parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Me këtë ligj janë të përcaktuar kompetencat vetanake dhe ato të deleguara.

2 Komuna e Prishtinës. Prishtina Online. Qyteti. Burim: <https://prishtinaonline.com/qyteti>

3 Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021, fq.33. Burim: <https://ask.rks-gov.net/media/6114/vjetari-statistikor-2021f.pdf>

4 Ibid, fq. 205.

5 Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji nr. 03/L-040 (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III / Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008). Burim: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Shërbimet komunale ofrohen nga ndërrmarrjet publike locale, siç janë; **Trafiku Urban, Ndërrmarrja Publike Banesore, Ndërrmarrja Publike "Hortikultura", Kompania Publike Komunale "Sportmarketing", Stacioni i Autobusëve, Prishtina Parking, Kuzhina Qendrore dhe "TERMOKOS". Shërbimet e ujit dhe administrimit të mbeturinave kryhen nga kompani regjionale (Pastrimi dhe Ibër Lepenc).**

Shërbimet dytësore të shëndetësisë ofrohen nga qendrat e mjekësisë familjare. Prishtina nuk ka një spital të vetin, por shërbimet emergjente për qyetarët e Prishtinës ofrohen nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Sa i përket sigurisë, përveq këshillave për siguri në bashkësi nuk ka ndonjë organ të veçantë që ofron siguri, mirëpo kjo mbështetet nga Policia e Kosovës.

Me miratimin e Ligjit për Kryeqytetin, Prishtinës i janë dhënë disa kompetenca shtesë në mënyrë që si kryeqytet të funksionojë në mënyrë më efektive. Për zbatimin e këtyre përgjegjësi i është dhënë edhe një financim shtesë, përkatësisht një grant shtesë jo më pak se 6%. Megjithatë, këto kompetenca shtesë ende nuk kanë arritur të zbatohen në praktikë në mënyrë të mirëfilltë. Kjo në disa raste reflektohet si pasojë e ndërrimeve politike në nivelin qendror. Nga ana tjetër, situata e pandemisë ka bërë që gjatë vitit 2020 të gjitha institucionet të mobilizohen në menaxhimin e situatës dhe zbatimi i këtyre kompetencave të mbetet anash.

Megjithatë, edhe pas 3 viteve nuk ka ndonjë monitorim të mirëfilltë të zbatimit të këtij Ligji. MAPL e cila është përgjegjëse për monitorimin e komunave dhe publikon raporte lidhur me monitorimin, merrë për bazë kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Deri më tani nuk ka ndonjë raport apo analizë lidhur me zbatimin e Ligjit për Kryeqytetin e cila pasqyron zbatimin dhe ngecjet në zbatimin e këtij Ligji. Në anën tjetër, as Kuvendi i Kosovës si organ ligjvënës nuk ka bërë një monitorim të tillë. Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, i cili është përgjegjës për analizimin e zbatimit të këtij ligji, asnjëherë nuk ka kërkuar raportim nga ana e institucioneve përgjegjëse lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Ligji për Kryeqytetin i ofron Kryeqytetit një autonomi më të madhe lidhur me ofrimin e shërbimeve publike, sigurinë dhe shëndetësinë, mirëpo zbatueshmëria e tyre do të paraqitet në kapitullin në vijim

4

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E VEÇANTA TË KRYEQYTETIT

Ligji për Kryeqytetin e Kosovës i jep disa të drejta dhe përgjegjësi të veçanta Prishtinës në krahasim me komunat e tjera, por pjesa më e madhe e neneve të Ligjit për Prishtinën ofrojnë të drejta që Prishtina si komunë i ka pasur edhe para miratimit të këtij Ligji.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e veçanta konsistojnë në aspektin e sigurisë, shëndetësisë, ndërmarrësisë, të drejta pronësore, financiare dhe pjesërisht administrative.⁶

4.1. Simbolet e Kryeqytetit

E drejta e komunave për përcaktimin e simboleve të komunave përcaktohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 7), e cila kërkon që më 2/3 e votimit të Kuvendit të Komunës të miratohen apo ndryshohen ato. Prishtina, sikurse komunat tjera ka miratuar këto simbole dhe i përdorë ato për nevoja zyrtare. Megjithatë, bazuar në Ligjin për Prishtinën, Kryeqyteti ka stemën, vulën, emblemën dhe flamurin e vet në pajtim me legjislacionin për vetëqeverisje lokale dhe ligjet tjera përkatëse⁷. Pas miratimit të këtij Ligji, nuk ka ndryshuar ose nuk është shtuar ndonjë nga këto simbole. Në të gjitha simbolet e Prishtinës dhe aktet e saj figurojnë emri komuna e Prishtinës dhe jo Kryeqyteti i Republikës së Kosovës Prishtina.

Statuti i Komunës së Prishtinës, është miratuar në vitin 2010 dhe përcakton se “Komuna është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale”⁸. Kompetencat dhe përgjegjësitë

⁶ Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>

⁷ Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Neni 6. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>

⁸ Neni 2, Statuti i Komunës së Prishtinës, miratuar me 25.02.2010. Burim: <https://ëëë.prishtinaonline.com/uploads/statuti-i-komunes-se-prishtines-2010.pdf>

janë të specifikuara sikur edhe për komunat tjera. Si akti më i lartë Kryeqytetit nuk ka ndonjë dispozitë që përmban obligimet e dala sipas Ligjit të Prishtinës. Udhëheqësit aktual të Prishtinës i konsiderojnë simbolet të finalizuara para kohës së miratimit të Ligjit për Kryeqytetin, si dhe nuk e kanë parë të arsyeshme dhe nuk kanë marrë ndonjë iniciativë për ndërrimin e tyre, përkatësisht përcaktimin e tyre me ermin Kryeqyteti i Republikës së Kosovës-Prishtina.⁹

4.2. Siguria publike e Kryeqytetit

Me ligjin për Prishtinën, siguria publike ushtrohet përmes Drejtorisë së Policisë për Kryeqytetin. Kjo drejtori themelohet me kërkesë të Kryetarit të Kryeqytetit, ndërsa Kuvendi i Kryeqytetit ushtron mbikëqyrjen e politikave lokale të sigurisë të cilat bien në kompetencë të Kryeqyteti. Kuvendi i Kryeqytetit ka të drejtën të kërkoj nga drejtori i policisë së Kryeqytetit të informoj lidhur me gjendjen e sigurisë.¹⁰

Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat që janë të banuara me popullatë shumicë serbe, brenda kompetencave të zgjeruara u lejohet përfaqësimi në përzgjedhjen e komandantëve të stacioneve përkatëse të policisë, sipas Ligjit të Policisë së Kosovës.¹¹ Në Ligjin për Policinë e Kosovës saktësohet se në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve i emëron Ministria e Punëve të Brendshme me propozimin e Kuvendit Komunal dhe Drejtorit të Përgjithshëm. Kur pozita e komandantit të stacionit ose komandantit të nënstacionit lirohet, Drejtori i Përgjithshëm do t'ia dërgojë një kërkesë me shkrim Kuvendit Komunal. Bashkë me kërkesën. Drejtori i Përgjithshëm do të dërgojë edhe një listë me të gjithë kandidatët e përshtatshëm për pozitën dhe do të kërkojë nga Kuvendi Komunal të rekomandoj së paku dy kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret minimale për pozitë nga lista.¹² Në Ligjin për Prishtinën Kryetari i Kryeqytetit pas aproviimit nga Kuvendi i Kryeqytetit i propozon Drejtorit të përgjithshëm të policisë, minimumin dy (2) kandidatë për Drejtorë të Drejtorisë së Policisë për Kryeqytetin dhe njëri nga këta merr detyrën e Komandantit të policisë.¹³ Ky formulim në Ligjin për Kryeqytetin e benë të veçantë në dy raste kompetencen e emërimit të komandantit të policisë për dallim nga praktika e ndjekur në rastet e komunave me shumicë popullatë serbe. E para: emrat për komandantin e policisë propozohen nga kryeqyteti dhe jo nga drejtorja e policisë dhe drejtorja e policisë nuk mund të refuzojë të dy emrat e propozuar, por duhet të vendos për njërin nga dy emrat që Kryeqyteti propozon.¹⁴

Ligji nuk specifikon se çfarë të drejtash, përgjegjësi apo kompetenca do të ketë Drejtorja e veçantë e policisë për Kryeqytetin. Poashtu nuk specifikohet se nga kush kjo drejtori pranon udhëzime për punët në terren (udhëheqëseve të Prishtinës apo të Drejtorisë së Përgjithshme të policisë)¹⁵ dhe njëherazi nuk bëhet e ditur forma e rekrutimit të policëve që do t'i shërbejnë kryeqytetit. Për më tepër, Ligji për Prishtinën nuk specifikon mandatin Komandantit (kohëzgjat-

9 Intervistë me Nënkryetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.

10 Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Neni 7. Pika 1.1 deri në piken 1.1.6. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>

11 Ligji Nr. 03/L-040. Qershor 2008. Neni 19 dhe neni 23. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3nqm2ei>

12 Ligji nr. 04/L-076. Mars 2021. Neni 42. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/32R4obp>

13 Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Neni 7 pika 1.2. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>

14 Intervistë me Shkelqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Pushtetit Lokal.

15 Televizioni "Kohavision". Intervistë e Kryetarit të Prishtinës Shpend Ahmeti. Minuta 3:05. Titulli i kronikës: Prishtina pa polici komunale, tri vite pas miratimit të Ligjit për kryeqytetin. Datë 4 prill 2021. Burim: <https://bit.ly/2QMF5VM>

jen e tij/saj) dhe nuk bëhet e ditur mënyra e vlerësimit ose shkarkimit të tij/saj në rast të mos përmbushjes së detyrave.¹⁶ Zbrazëti ligjore poashtu janë çështjet teknike nëse policia e paraparë për punët e kryeqytetit duhet të ketë automjete, uniformë dhe pajisje të njejta me policinë e rregullt apo të ndryshme.

Ligji për kryeqytetin ka paraparë fushën e sigurisë që do të ketë kjo drejtori. Kjo fushë del jashtë funksionit dhe natyrës së qeverisjes lokale, ngase çështjet e sigurisë lidhen me rastet e vrasjeve, vjedhjeve, plaqkitjeve, kërcënimeve, dhunës në forma të ndryshme e kështu me radhë.¹⁷ Sipas Ligjit për Policinë e Kosovës saktësohet se secila komunë e Kosovës duhet ta themeloj Keshillin Komunal për Siguri në Bashkesi. Qëllimi i Këshillit të Sigurisë është që ta zhvilloj vetëdijesimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t'i identifikoj brengat lidhur me sigurinë, publike dhe t'i rekomandoj planet e veprimit, për t'i adresuar këto brenga me përpjekje bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale dhe policisë.¹⁸ Rasti i Shqipërisë tregon se policia bashkiake në Tiranë ka mandat për rendin publik, por jo për sigurinë publike.¹⁹

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) si autoritet përgjegjës për sigurinë publike, nuk ka ndërmarrë ndonjë iniciativë për nxjerrjen e ndonjë akti ligjor me të cilin do të përcaktoheshin procedurat për mënyrën e krijimit dhe funksionimit të drejtorisë së posaqme brenda policisë së Kosovës për Kryeqytetin, ndërsa tani për tani nuk ka ndonjë plan se kur do të mund të iniconte një akt të tillë. Komuna e Prishtinës i ka adresuar tri kërkesa në MPB për hartimin e një akti të tillë, por që në asnjë rast nuk ka marrë përgjigje në shkresat/kërkesat e adresuara.²⁰

Aktualisht Policia e Kosovës i asiston Komunës së Prishtinës në disa aksione, por kjo konsiderohet e pamjaftueshme dhe jo krejt e pershtatshme, ngase për çfarëdo asistence që i duhet Prishtinës nga policia duhet ta njoftojë këtë institucion 72 orë me herët dhe poashtu në disa raste Komuna e Prishtinës paguan policët për angazhim të tyre jashtë orarit zyrtar të punës për t'u angazhuar në kërkesat e kryeqytetit.²¹ Komuna e Prishtinës për çdo vit në buxhetin e saj parasheh rreth 1 milion euro për nevojat e krijimit dhe funksionalizimit të Drejtorisë së posaqme të policisë së Kosovës që do t'i shërbejnë kryeqytetit. Ky buxhet bartet nga viti në vit.²² Mungesa e policisë së veçantë për kryeqytetin aktualisht është duke e bërë jo krejtësisht efikas çështjen e rregullimit të hapësirave publike për parking të veturave, qarkullimin e vazhdushëm të taksive ilegal, shfrytëzimin e pa autorizuar hapësirave nga shitësitë ambulante, shfrytëzimin, si dhe mos ndëshkimin e dëmeve që personat u bëjnë aseteve publike.

16 Intervistë me Shkelqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Pushtetit Lokal.

17 Intervistë Sadri Rrmoku, kordinatorë i projekteve në Institutin Kosovar për Qeverisje Lokale.

18 Ligji nr. 04/I-076 për Policinë. Neni 7. Burim: <https://bit.ly/3f13gsA>

19 Ligji nr. 8224 për Policinë Bashkiake. Neni 8. Burimi: <https://bit.ly/3knYAiM>

20 Intervistë me Nënkryetarin e Prishtinës Muhedin Nushi.

21 Intervistë me Nënkryetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.

22 Intervistë me Nënkryetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.

4.3. Shërbimet e kujdesit dytësor shëndetësor

Kosova aktualisht ka gjashtë spitale të përgjithshme ku gravitojnë 30 komuna të Kosovës, por vetëm regjioni i Prishtinës nuk e ka një të tillë²³, ndërsa shërbimet dytësore për qytetarët e Prishtinës ofrohen nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës e cila është e mbi ngarkuar në ofrimin e shërbimeve edhe për qytetarët e komunave tjera. Kjo si pasojë e asaj se qytetarët shumë herë e besojnë se QKUK ofron shërbime më të mira, mirëpo në të shumtën e rasteve edhe spitalet tjera i referojnë pacientët në QKUK si raste urgjente dhe për tretman më të mirë. Ligji për Kryeqytetin parasheh që Prishtina mund të ofrojë shërbime dytësore shëndetësore dhe të themelojë spitalin e përgjithshëm, që do të ishte nën menaxhimin e kryeqytetit.²⁴

Sa i përket ndërtimit të spitalit të Prishtinës, disa nisma të ndërmarra nuk janë konkretizuar. Në shtator 2019, Ministri i Administratës Publike, Mahir Yagcilar në koordinim dhe prani të ish-Ministrit të Shëndetësisë Uran Ismaili dhe perfaqësuesja e kompanisë ICME kanë nënshkruar marrëveshje për fillimin e Studimit të Fizibilitetit për Spitalin e Prishtinës. Fizibiliteti ishte menduar si hap i parë, për të vazhduar pastaj me zhvillimin e projektit dhe ndërtimin e spitalit. Paraprakisht, me 4 prill 2019 Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, së bashku me ministrin e Administratës Publike, Mahir Yagcilar, kishin nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit për fillimin e ndërtimit të Spitalit të Prishtinës, i cili përcaktonte obligimet institucionale për realizimin sa më të shpejtë dhe efikas të projektit.²⁵

Projekti sipas memorandumit do të realizohej në katër faza: 1. Realizimi i Studimit të Nevojave dhe Vlerësimit të Kapaciteteve; 2. Themelimi i Spitalit të përgjithshëm të kryeqytetit, ashtu siç përcaktohet me Ligin për Kryeqytetin; 3. Hartimi i projektit detal për ndërtimin në bazë të Studimit; 4. Ndërtimi i objektit në bazë të projektit detal si dhe mbikëqyrja profesionale e fazës së ndërtimit. Për studimin e fizibilitetit Ministria e Administratës Publike ka ndarë 500 mijë euro. Megjithatë, asokohe parashihej që koston dhe kapacitetin e spitalit do ta përcaktonte studimi i fizibilitetit që do të udhëhiqej nga Ministria e Administratës Publike. Në vitin 2020 shuma e paraparë buxhetore është rialokuar në projekte të tjera.²⁶

Ministrat Yagcilar dhe Ismaili kishin deklaruar asokohe se ky projekt do të finalizohet brenda 5 muajve. Në periudhën e paraparë ka rënë Qeveria Haradinaj, e cila pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 i dorëzoi mandatin Qeverisë Kurti 1, e cila me të marrë të mandatit është ballafaqur me pandeminë COVID-19. Për shkak të emergjencës së shëndetit publik që ka sjellë COVID-19, ky projekt dhe këto nisma deri tash (maj 2021) nuk kanë pasur ndonjë progres të ri.²⁷ Megjithatë, as në programin e qeverisë Kurti II (2021 – 2025) nuk është paraparë ndonjë hap ose veprim në ndërtimin e këtij spitali.²⁸

Nga ana tjetër, Komuna e Prishtinës nuk ka planifikuar ende lokacionin për ndërtimin e këtij spitali, nuk është futur në buxhetin e vitit 2021 dhe përveç kësaj akoma nuk ekziston ndonjë nismë për vlerësimin e potencialeve të resurseve humane që ka nevojë të ekzistojnë për të mbajtur kujdesin parësor, por edhe për të zhvilluar edhe shërbimin dytësor shëndetësor.²⁹

23 Portali Shtetëror i Kosovës. Institucionet shëndetësore në territorin e Kosovës. Lista. Burim: <https://bit.ly/3u03MMë>

24 Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Neni 7 pika 1.2. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>

25 Përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë në kërkesen e adresuar për qasje në të dhëna publike. Faik Hoti. Datë 28.04.2021.

26 Ibid

27 Përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë në kërkesen e adresuar për qasje në të dhëna publike. Faik Hoti. Datë 28.04.2021.

28 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 –2025. Burim: <https://bit.ly/3oKËJFO>

29 Televizioni "Kohavision". Titulli i kronikës: Prishtina pa spital kërkon mosmbyllje të shërbimeve në QKUK. Datë 19.03.2021. Burim: <https://bit.ly/3ehPphd>

Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Komuna e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës dhe ajo e Shtërpçës kanë kompetenca për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin, ekzekutimin e pagave dhe trajnimin e personelit të përkujdesit shëndetësor dytësorë.³⁰ Kompetenca që i është dhënë Prishtinës në Ligjin për Kryeqytetin përveç të drejtës për të pasur shërbim dytësorë shëndetësor nuk e përfshinë edhe përgjegjësinë e licensimit dhe nuk përmendet fusha e pagave dhe ajo e trajnimeve. Sipas Ligjit për shëndetësi në Kosovë, komunat (përfshirë Mitrovica e Veriut, Graçanica dhe Shtërpca) nuk kanë të drejtë të licensojnë shërbime shëndetësore. Të gjitha institucionet shëndetësore mund të fillojnë punën vetëm pas licencimit nga Ministria ose nga organi i autorizuar prej saj dhe kjo bëhet duke përcaktuar kushtet specifike për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve medicinale.³¹

4.4. Shërbimet publike

Me Ligjin për Ndërmarrjet Publike në Kosovë përcaktohet se çdo ndërmarrje e re publike me shtrirje nacionale, regjionale apo lokale mund të themelohet vetëm nëse kjo miratohet paraprakisht nga ana e qeverisë.³² Qeveria e Kosovës në vitin 2013 ka miratuar një rregullore mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale, por edhe në këtë rregullore e drejta për të shqyrtuar/refuzuar apo aprovuar kërkesat për themelimin e një ndërmarrje publike/lokale bie mbi qeverinë. Komunitat paraqesin kërkesë në NJPMNP (Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Ekonomisë) për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale. Pas shqyrtimit të kërkesave, NJPMNP i dërgon Komisionit Ministror për Ndërmarrjet Publike. Nëse Komisioni Ministror konstaton se janë plotësuar kriteret, ajo e dërgon kërkesën për aprovim të Qeverisë e Kosovës.³³

Në Ligjin për Kryeqytetin përcaktohet e drejta për themelimin dhe menaxhimin e ndërmarrjeve publike lokale që shërbejnë vetëm për territorin e Kryeqytetit. Themelimi i ndërmarrjeve publike lokale në Kryeqytet bëhet me propozim të Kryetarit të Kryeqytetit, i shoqëruar me planin e biznesit dhe analizën financiare dhe miratohet me 2/3 e votave të anëtarëve të Kuvendit të Kryeqytetit. Për dallim nga procedurat e përcaktuara me Ligjin për ndërmarrje publike dhe akteve të tij nën ligjore, procedurat për themelimin e ndërmarrjes publike lokale të Kryeqytetit nuk kërkojnë marrjen e pëlqimit nga Qeveria.³⁴

Deri tani, është bërë themelimi i ndërmarrjes publike/lokale “Kuzhina Qendrore” dhe funksionalizimi i ndërmarrjes publike/lokale “Prishtina Parking”. Të dy këto ndërmarrje kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Kryeqytetit. Ndërmarrja publike lokale “Kuzhina Qendrore” është themeluar në qershor të 2019 me qëllim të ofrimit të ushqimit për çerdhet e kryeqytetit, ndërsa në një fazë tjetër është planifikuar edhe përgaditja e ushqimit për nxënësit e shkollave të mesme të ulta. Ndërmarrja publike “Prishtina Parking” ka filluar të bëjë menaxhimin e hapësirave publike të destinuara për parking, si dhe ka përcaktuar tarifën për parking të automjeteve.

30 Ligji Nr. 03/L-040. Qershor 2008. Neni 20. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3nqm2ei>

31 Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Neni 42. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Maj 2013 Burim: <https://bit.ly/3frz9tv>

32 Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Neni 11. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3hDSXg2>

33 Rregullorja Rregullore Nr.02/2013 mbi Kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrja e Komunave në bordet e drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të ujit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Neni 6. Burim: <https://bit.ly/3uEGAzk>

34 Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Neni 7. Pika 1.3.1 deri në 1.3.4. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>

Mjetet nga tarifat e parkingjeve janë të hyra vetanake të Kryeqytetit dhe menaxhohen sipas ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

4.5. Prona e Kryeqytetit

Çështjet pronësore janë një kompetencë tjetër e përcaktuar me Ligjin për Kryeqytetin. Në ligj theksohet se prona e luajshme dhe e paluajshme që është në pronësi të Komunës së Prishtinës me hyrjen në fuqi të këtij ligji, regjistrohet në pronësi të Kryeqytetit. Në komunë ekzistojnë pesë lloje të pronave: prona private, prona komunale, prona publike (që menaxhohet nga ndërmarrjet publike KEK, PTK) prona shoqërore (që menaxhohet nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit) dhe prona të regjistruara në emër të kompanive regjionale (ujësjellësit). Komuna ekskluzivisht menaxhon vetëm prona komunale.³⁵ Sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajshme të komunës saktësohet se pronë e paluajshme e komunës nënkupton pronën e paluajshme e regjistruar në emër të komunës në regjistrin zyrtar kadastral.³⁶

Dispozitat e këtij ligji kanë gjetur zbatim në rastin e ish shtëpisë së mallrave "Germia" e cila tani është regjistruar si pronë e Kryeqytetit dhe poashtu hapësira në dhe rreth fabrikës 'IMN Kosova', e njohur dikur si "Cigllana" ka kaluar në pronësi të Kryeqytetit.³⁷

Me Ligjin për Kryeqytetin poashtu thuhet se organet kompetente kadastrale bëjnë korrigjimin e të dhënave kadastrale dhe pronësore sipas detyrës zyrtare për të bartur pronësinë prej Komunës së Prishtinës në emër të Kryeqytetit.³⁸ Megjithatë, ekziston një paqartësi ligjore se ku është dallimi në këtë rast mes pronës së mëhershme komunale dhe pronës së paraparë në Ligj si pronë e kryeqytetit.³⁹ Kjo ka bërë që të mos ketë ndonjë korrigjim në të dhënat kadastrale lidhur me titullarin e pronës së komunës.

35 Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë. 2016. Fq 23 deri 29. Burim: <https://bit.ly/3bSF21X>

36 Ligji NR. 06/L-092. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajshme të Komunës. Prill 2019. Neni 3. Burim: <https://bit.ly/3ububX6>

37 Intervistë me Nënkyetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.

38 Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Neni 18. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>

39 Intervistë me Nënkyetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.

4.6. Nënkrjetarët e Kryeqytetit dhe stafi mbështetës

Për dallim nga komunat tjera të cilat sipas Ligjit për Veteqeverisje Lokale kanë të drejtë të kenë një nënkryetar, me Ligjin për Kryeqytetin Prishtina mund të këtë dy nënkryetar të emeruar nga Kryetari.⁴⁰ Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, Kryetari i Prishtinës ka emeruar edhe një nënkryetar.

Kryetari poashtu mund të emëroj deri në pesë këshilltarë, të cilët e këshillojnë në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij/saj, të cilët/at i emëron dhe i shkarkon Kryetari. Ligji për Kryeqytetin ka rregulluar edhe pozitat e personelit në kabinetin e Kryetarit. Në kuadër të stafit administrativ të Kryetarit bëjnë pjesë: shefi i kabinetit, asistenti administrativ dhe zyrtari i logjistikës. Të punësuarit në kabinetin e kryetarit nuk janë nëpunës civil dhe u pushon mandati me përfundimin e mandatit të Kryetarit.⁴¹ Mbi këtë bazë juridike, Kryetari i Prishtinës ka emeruar tre këshilltar të cilët e ndihmojnë/këshillojnë Kryetarin në lidhje me politikën publike në nivel lokal.⁴²

4.7. Taksa shtesë

Nje ngecje tjeter që del nga Ligji për Prishtinën ka të bëjë me nenin 19 pika 8, ku thuhet se Prishtina cakton taksë shtesë për kryeqytetin. Kjo ngecje është manifestuar edhe me paqartësi ngase Ligji nuk precizon se për cilat taksa bëhet fjalë dhe poashtu autoritetet nuk e kanë të qartë nëse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal apo Komuna e Prishtinës duhet të nxjerrin ndonjë akt nenligjor që do të saktësonte detajet e kësaj të drejtë të Kryeqytetit.⁴³

4.8. Shërbimi i Kuvendit të Kryeqytetit

Ligji për Kryeqytetin në nenin 11 dhe 12 flet për organizimin dhe funksionet e Kuvendit Komunal të Kryeqytetit. përmbajtja e këtyre nenëve është përcaktuar edhe Ligjnit për Veteqeverisje Lokale, përkatësisht i nenit 35, 36, 39, 40 dhe nenit 51, nene këto që rregullojnë në tërësi organizimin, fushëveprimin dhe mandatin e Kuvendeve Komunale. Për dallim nga Ligji për Veteqeverisje Lokale, Ligji për Kryeqytetin të pjesa e Kuvendit Komunal ka paraparë që Kuvendi i Kryeqytetit ka shërbimin profesional me status të nëpunësit civil i cili përbëhet nga shefi i shërbimit të Kuvendit, zyrtarit ligjor dhe procesmbajtësit. Struktura e punës dhe të punësuarëve në Kuvendin komunal të Prishtinës nuk ka ndryshuar krahasuar me periudhen e para dhe pas miratimit të Ligjit për Prishtinën. Struktura e të punësuarëve të Kuvendit Komunal të Prishtinës është i rregulluar në nivel të sektorit (sektori i Kuvendit) sektori është pjesë përbërëse e Drejtorisë së përgjithshme të Administratës. Ky sektor përbehet nga shtatë persona të punësuar që mbajnë pozita si zyrtar i lartë i Kuvendit, procesmbajtës, koordinues, asistent dhe përkthyes.⁴⁴ Pas miratimit të Ligjit për Kryeqytetin, pozitat dhe numri i të punësuarëve në Kuvendin Komunal të Prishtinës nuk ka ndryshuar.⁴⁵

40 Ligji Nr. 03/L-040. Qershor 2008. Neni 60. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3nqm2ei>

41 Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Neni 15. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>

42 Intervistë me Avni Zuka. Shef i personelit në Komunën e Prishtinës.

43 Intervistë me Nënkrjetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.

44 Intervistë me Avni Zuka. Shef i personelit në Komunën e Prishtinës

45 Ibid.

4.9. Dekoncentrimi i shërbimeve administrative

Ligji për Kryeqytetin ka përcaktuar të drejten e Prishtinës që shërbimet administrative të mund t'i bartë si shërbime edhe në bashkësitë lokale (nenin 16 në paragrafi 3). Dekoncentrimi i shërbimeve administrative në nivel lokal në Prishtinë ka filluar në vitin 2014 dhe është përmbyllur në gjysmën e dytë të vitit 2016, dy vite para se Ligji për Prishtinën të merrte aprovimin në Kuvendin e Kosovës.⁴⁶ Prishtina aktualisht është e ndarë në 33 bashkësi lokale, 14 janë të shtrira në zonat urbane të qytetit, ndërsa 19 në zonat rurale.⁴⁷ Në 2016 në këto bashkësi lokale është bartur e drejta që të lëshojnë për palë 13 lloje të ndryshme të dokumenteve të cilat para këtij viti kanë mundur të tërhiqen vetëm nga sportelet e objektit kryesor komunal. Dokumentet që lëshohen në këto bashkësi lokale janë: Vërtetim për letërnjoftim për shtetas të huaj (për letërnjoftim të përkohshëm), vërtetim për pasaportë, vërtetim për vendbanim dhe vendqëndrim, vërtetim për ndihmë sociale, vërtetim për regjistrim në shkollë dhe çerdhe, vërtetim për aplikim për vizë, vërtetim për udhëtim, vërtetim për pension, vërtetim për regjistrimin e automjeteve, vërtetim për kurorëzim, vërtetim për ndërrim të vendbanimit, vërtetim për nënshtetësi dhe vërtetim për mbajtës të familjes për shtetas të huaj.⁴⁸ Pas aprovimit të Ligjit për Prishtinën, nuk ka ndonjë kompetencë tjetër e cila është bartë në bashkësitë lokale.

4.10. Financimi i Kryeqytetit

Edhe në aspektin e financimit Prishtina ka përfituar grant shtesë, përveç granteve të rregullta që u ndahen komunave. Kryeqytetit i jepet një grant i veçantë në lartësinë jo më pak se gjashtë përqind e grantit të përgjithshëm të komunave, të përcaktuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, për secilin vit fiskal. Kjo ndarje merr si referencë vetëm vlerën e grantit të përgjithshëm të komunave dhe nuk merret nga ky grant, por ndahet specifikisht nga buxheti qendror. Granti i veçantë për Kryeqytetin bartet në grantin e përgjithshëm dhe të gjitha shpenzimet bëhet nga kjo linjë buxhetore.

Shpenzimet për kryerjen e kompetencave shtesë të kryeqytetit të parapara me Ligj për Kryeqytetin parashihen në ndarjet e rregullta buxhetore të përcaktuara nga buxheti qendror. Shëndetësia dytësore trajtohet në kuadër të grantit të shëndetësisë nuk mbulohet nga granti shtesë për Kryeqytetin. Ministria e Financave që nga viti 2019 në buxhetin e paraqitur në Kuvendin e Kosovës e ka përparë grantin e përfshirë në Ligjin për Kryeqytetin.⁴⁹ Kryeqyteti obligohet të dorëzoj planifikimin për grantin për Kryeqytetin për kompetencat shtesë çdo vit fiskal sipas afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave.⁵⁰ Nga ana tjetër, Prishtina për çdo vit paraqet në Ministrinë e Financave raportin lidhur me alokimet e mjeteve që do t'i pranojë nga Ligji për Kryeqytetin.⁵¹ Ligji për Kryeqytetin i jep Prishtinës një shumë të konsiderueshme buxhetore mbi baza vjetore dhe qëllimi i këtij granti specifikohet në ligj për të mbuluar nevojat e kryeqytetit në zbatimin e ligjit, por edhe në rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike.

46 Intervistë me Nënkryetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.

47 Komuna e Prishtinës. Prishtina Open Data. Lista e Kryetarëve dhe anëtarëve të Bashkësisë Lokale në Prishtinë. Burim: <https://bit.ly/3feK0lc>

48 Komuna e Prishtinës. Rubrika lajmet. 2014. Burim: <https://bit.ly/3hUv9oZ>

49 Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave dhe Transfereve. Qarkorja buxhetore 2020 – 2021. Fq 12. Burim: <https://bit.ly/3h1vC7y>

50 Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Neni 19. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>


51 Intervistë me Nënkryetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.

Në Kosovë nuk është vetëm Prishtina që ka të hyra të veçanta buxhetore, jashtë granteve të parapara për secilen komunë. Janë katër komuna në veriun e Kosovës (Leposaviqi, Zubin Potoku, Zveçani dhe Mitrovica e Veriut) që gezojnë të hyra të veçanta përmes zhdoganimit të mallrave në pikën 1 dhe 31 (Bërnjak dhe Jarinjë) dhe të hyrat nga këto mallra dedikohen si të hyra direkte për komunat e veriut, i njohur ndryshe si fondi për veriun.⁵² Gjatë vitit 2020 nga këto pika janë zhdoganuar mallra në vlerë nga 800 mijë euro.⁵³

Poashtu të hyra të veçanta buxhetore ka edhe komuna e Obiliqit, madje për këtë komunë është miratuar në dhjetor të 2016 edhe një Ligj i veçantë. Madje kjo komunë (Obiliq) me ligjin e miratuar përcaktohet saktë zona që konsiderohet e rrezikuar nga ndotja dhe poashtu parashihet që kjo zonë të këtë tarifa me të lira të energjisë elektrike, qasje të favorizuar në punësim në termocentralet, përfiton qasje në avullin e termocentraleve për kyqje në sistemin e kogjenerimit (ngrohjes) dhe po ashtu inkasimit të rentës minerale nga institucioni përkatës, 20% e vlerës së kësaj rente rialokohet nga buxheti qendror për buxhetin komunal të Komunës.⁵⁴ Gjatë vitit 2018 e tutje. Komuna e Obiliqit ka përfituar nga renta minerale deri në 5 milionë euro në vit.⁵⁵ Në pikëpamje të qeverisjes lokale në Kosovë nuk është vetëm Prishtina që përfiton të hyra të veçanta buxhetore, është edhe Obiliqi (nga renta minerale e termocentraleve) Prizreni (për zonen historike të qytetit) Rahoveci (nga Ligji për fshatin Hoqë e Madhe) dhe Dragashi (nga zona e Zymit të Hasit)

Sipas formulës së ndarjes së granteve për njesitë e pushtetit lokal në Kosovë, Prizreni, Rahoveci dhe Dragashi marrin një shumë shtesë të mjeteve nga buxheti qendror, Prizreni për shkak të qendres historike, Rahoveci për shkak të fshatit Hoqë dhe Dragashi shkak i rajonit të Zymit. Për zonën historike të Prizrenit ekziston edhe një Ligj i veçantë i miratuar në korrik të 2012.⁵⁶ Poashtu edhe për fshatin Hoqë e Madhe dhe Zym i Hasit.⁵⁷

Buxheti vjetor i komunës së Prishtinës, para dhe pas miratimit të Ligjit për Kryeqytetin



52 Zyra Kombëtare e Auditimit. Zbatimi i rekomandimeve të raportit "Fondi Zhvillimor" dhe efektet e fondit. Fq 1 dhe 5. 2017. Burim: <https://bit.ly/3nME5N8>

53 Dogana e Kosovës. Kërkesë për qasje në të dhëna publike. Adriatik Stavileci. Datë 26.04.2021


54 Ligji Nr. 05/L-044. Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij. Dhjetor 2016. Neni 5 dhe 6. Burim: <https://bit.ly/33hdnCV>

55 Intervistë me Abdurrahman Krasniqin, shef i kabinetit të kryetarit të komunës së Obiliqit.

56 Ligji Nr. 04/L-066. Qendrën Historike të Prizrenit. Korrik 2012. Burim: <https://bit.ly/3ukeT3e>


57 Ligji Nr. 04/L-62. Për fshatin Hoqë e Madhe. Korrik 2012. Burim: <https://bit.ly/3unuEGs> dhe Ligji Ligji NR. 04/L-196. Zym i Hasit. Burim: <https://bit.ly/3ejil33>

Buxheti i Kryeqytetit në përqindje sipas kategorive (2021)



Burim: Komuna e Prishtinës (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020 -2022)

Buxheti i Kryeqytetit bazuar nshumat e prgjithshme sipas kategorive (2021)



Burim: Komuna e Prishtinës (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020 -2022)

Tabela 1. Paraqet nivelin e zbatimit të përgjegjësive të cilat dalin nga Ligji për Kryeqytetin

Neni	Përmbajtja	Është përbushur	Nuk është përbushur	Pjesërisht i përbushur
Neni 6	Kryeqyteti ka stemën, vulën, emblemën dhe flamurin e vet		X	
Neni 7	Policia themelon Drejtorinë e Policisë për Kryeqytetin		X	
Neni 7	Kryeqyteti ka kompetenca për përkujdesin dytësor shëndetësor		X	
Neni 7	Kryeqyteti themelon spitalin e përgjithshëm të Kryeqytetit		X	
Neni 7	Kryeqyteti themelon dhe menaxhon ndërmarrje publike lokale	X		
Neni 13	Kuvendi i Kryeqytetit ka shërbimin profesional me status të nëpunësit civil i cili përbëhet ngashefi i shërbimit të Kuvendit, zyrtari ligjor dhe Procesmbajtësi		X	
Neni 15	Kryetari i Kryeqytetit ka dy (2) nënkryetarë	X		
Neni	Kryetari mund të emëroj deri në pesë (5) këshilltarë	X		
Neni 15	Në kuadër të stafit administrativ të Kryetarit bëjnë pjesë: shefi i kabinetit, asistenti administrativ dhe zyrtari i logjistikës.	X		
Neni 16	Kryeqyteti bënë dekoncentrimin e shërbimeve administrative		X	
Neni 18	Prona e luajtshme dhe e paluajtshme që është në pronësi të Komunës së Prishtinës regjistrohet në pronësi të Kryeqytetit.		X	
Neni 18	Organet kompetente kadastrale bëjnë korrigjimin e të dhënave kadastrale dhe pronësore për të bartur pronësinë prej Komunës së Prishtinës në emër të Kryeqytetit.		X	
Neni 18	Kryeqyteti ka të drejtë të lidhë marrëveshje me Qeverinë lidhur me çështjet e pronësisë	X		
Neni 19	Kryeqytetit i Kosovës i jepet një grant shtesë në lartësinë jo më pak se gjashtë përqind (6%) e grantit të përgjithshëm të komunave	X		
Neni 19	Shpenzimet për kryerjen e kompetencave shtesë të kryeqytetit të parapara me këtë ligj parashihen në ndarjet e rregullta buxhetore të përcaktuara nga buxheti qendror.	X		
Neni 19	Kryeqyteti obligohet të dorëzoj planifikimin për grantin për Kryeqytetin për kompetencat shtesë çdo vit fiskal	X		
Neni 19	Kryeqyteti cakton taksë shtesë për kryeqytetin		X	

5

PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE TË RREGULLIMIT TË STATUSIT TË KRYEQYTETIT

Në veçanti, organizimi dhe funksionimi i kryeqyteteve në shumicën e vendeve rregullohet bazuar në nivelet shtetërore të qeverisjes. Në vendet më të mëdha, siç është rasti me Gjermaninë⁵⁸ dhe Austrinë⁵⁹ si shtete federale, kryeqytetet përbëjnë gjithashtu një provincë ku organizimi i qytetit / provincës ka struktura të ndryshme të organizimit, ndërsa kompetencat komunale janë plotësisht të decentralizuara. Në disa vende të tjera, ndarja rajonale e vendit krijon mundësi për të krijuar struktura të ndryshme për koordinimin dhe krijimin e politikave për qeveritë lokale, siç është rasti i Kroacisë⁶⁰.

Në vijim do të paraqitet rregullimi i statusit të Bratislavës, Shkupit dhe Tiranës, me qëllim që të pasqyrohet se si është bërë rregullimi i tyre, cilat janë kompetencat, financimi dhe ndarja administrative e këtyre qyteteve.

5.1. Qyteti i Bratislavës

Asambleja Kombëtare e Sllovakisë ka miratuar Aktin për kryeqytetet e Sllovakisë, Bratisllavën me të cilin i përcakton një status më të veçantë krahas qyteteve tjera në vend. Në nivelin komunal, Bratislava drejtohen nga kryetari i zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë dhe nga Këshilli i Qytetit i cili është organi përfaqësues. Bratislava ka një strukturë të dyfishtë të organeve, ato në nivel qyteti dhe organet nën-komunale të 17 rretheve. Secili rreth funksionon si një qytet dhe

58 The Governing Mayor. The Constitution of Berlin of 23 November 1995, as amended as of 22 March 2016. Burim: <https://www.berlin.de/rbmskzl/en/the-governing-mayor/the-constitution-of-berlin/> (Qasur me: 15 qershor 2021)

59 Informatat mund të gjenden në: <https://www.wien.gv.at/> (Qasur me: 20 qershor 2021)

60 Law of the Republic of Croatia on the City of Zagreb. Burim: <https://www.legislationline.org/documents/id/5864> (Qasur me: 20 qershor 2021)

kryesisht ndjek dispozitat ligjore për qytetet e tjera sllovake. Përfaqësuesit e nivelit të qytetit vendosin për çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me qytetin në tërësi.

Këshilli i Qytetit vendos për të gjitha çështjet që lidhen me kompetencat në nivelin e qytetit, siç janë: planifikimi ekonomik, kulturor dhe shoqëror, transporti publik urban, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale, furnizim me ujë dhe kanalizime, grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi i mbeturinave, si dhe ndriçimi rrugor. Shteti mund të delegoj kompetenca tjera për të cilat fillimisht alokohen fonde. Këshilli i Qytetit miraton buxhetin e qytetit dhe përcakton të gjitha kushtet të taksave vendore brenda kompetencave të veta.

Qyteti i Bratislavës është i ndarë në 17 rrethe. Në nivelin e rrethit, shefi ekzekutiv është kryetari i bashkisë së rrethit të qytetit. Numri i këshilltarëve të rretheve ndryshon në rrethe, ndërsa politika e tanishme është që numri i tyre gradualisht të zvogëlohet. Këshilltarët e rrethit zgjidhen nga të gjithë banorët, vendbanimi kryesor i të cilëve është në rreth, për një mandat prej katër vjetësh. Këshillat e rretheve kryejnë punën e tyre detyrat sipas rregullave të përbashkëta në lidhje me këshillin bashkiak të qytete në Sllovaki. Zgjedhjet për institucionet e rrethit zakonisht mbahen në të njëjtën kohë me zgjedhjet për institucionet e qytetit. Gjatë këtyre zgjedhjeve, zgjidhet kryetari i rrethit. Organi ekzekutiv i kryetarit të rrethit dhe i organit përfaqësues lokal (Këshilli i Rrethit). Këshilli i Rrethit vendos në mënyrë të pavarur për çështjet më të rëndësishme në nivelin e rrethit, përfshirë buxhetin dhe kushtet e taksave lokale brenda rrethit. Me Statutin e Bratislavës përcaktohet se këshillat e rrethit bëjnë: menaxhimin e buxhetit të rrethit, menaxhimin e pasurive të rrethit dhe pasurive të patundshme, menaxhimin e taksave lokale brenda kompetencës së rrethit, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e lokaleve, rrugëve dhe menaxhimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve historike lokale. Kompetencat e deleguara nga shteti për të cilat rrethet marrin fonde shtetërore u shtohen kompetencave origjinale. Kompetencat e deleguara nga shteti përfshijnë asistencën sociale, kujdesin për njerëzit e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara dhe menaxhimin e licencave për peshkim dhe gjueti. Secili rreth disponon me taksat e veta dhe përcakton shkallën e taksave. Ka edhe një sistem të shpërndarjes së burimeve fiskale midis nivelit të qytetit dhe rretheve.

5.2. Qyteti i Shkupit

Qyteti i Shkupit është rasti unik në qeverinë lokale të Maqedonisë së Veriut ku përgjegjësitë lokale shpërndahen në mënyrë rigorozë ndërmjet autoriteteve të Qytetit të Shkupit, si një bashkësi prej dhjetë komunave dhe autoriteteve të këtyre dhjetë komunave. Qyteti i Shkupit, në fushat brenda kompetencës së tij miraton dhe parashikon zbatimin e rregulloreve unike, siguron të njëjtin nivel të shërbimeve dhe qasje të barabartë për qytetarët, duke zbatuar të njëjtat standarde. Qyteti i Shkupit, brenda ligjit, në përputhje me parimin e subsidiaritë, ka të drejtë të kryejë në territorin e tij punimet me interes publik me rëndësi për Qytetin e Shkupit, të cilat nuk përjashtohen nga kompetenca e tij, ose nuk janë brenda kompetencave të autoriteteve shtetërore.

Organet e Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit janë Këshilli dhe kryetari i komunës. Këshilli i Qytetit të Shkupit është një organ përfaqësues i qytetarëve që ka fuqinë të marrë vendime brenda kornizave të kompetencës së Qytetit të Shkupit. Këshilli i Qytetit të Shkupit

përbëhet nga 45 anëtarë të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira. Kryetari i Bashkisë është organi përfaqësues dhe ekzekutiv në njësinë e qeverisjes vendore. Në kryerjen e punëve brenda kompetencave të Qytetit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, këshillat dhe kryetarët e komunave vendosin bashkëpunim të ndërsjellë, veçanërisht përmes: shkëmbimit të materialeve brenda kompetencës së tyre për informim të dyanshëm ose dhënien e pëlqimit, mbajtjen e seancave të përbashkët për hetimin e çështjeve brenda kompetencës së tyre dhe me interes të përbashkët, inicimin e akteve dhe masave për rregullimin e çështjeve me interes për Qytetin, etj.

Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, financohen nga burimet e të hyrave vetjake, të hyrat nga tatimet, të hyrat nga buxheti i shtetit, të hyrat nga interesi i borxheve në pajtim me ligjin dhe nga të hyra të tjera të përcaktuara me ligj. Për shkak të sigurimit të kushteve të barabarta për financimin e komunave në qytetin e Shkupit dhe për kënaqjen e nevojave të përbashkëta të qytetarëve në qytetin e Shkupit, ekziston Fondi i përbashkët i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit i cili formohet nga mjetet e tatimit mbi të ardhurat personale, taksat komunale për firma dhe taksat komunale për shfrytëzimin e rrugëve me automjete, mjete transporti dhe mjete me rimorkio dhe mjete tjera. Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, të hyrat nga Fondi i përbashkët i realizojnë në pajtim me metodologjinë për shpërndarje të mjeteve nga Fondi i Përbashkët të miratuar nga Ministria e Financave. Qytetit të Shkupit i lejohet që të përcaktojë shkallë më të lartë të tatimit mbi pronën (0,05%) mbi nivelin e përcaktuar me ligj, shkallë më të lartë të tatimit mbi qarkullimin e patundshmërive nga shkalla më e ulët e tatimit mbi qarkullim të patundshmërive, të përcaktuar me ligj, më së shumti deri në (1%), etj⁶¹.

5.3. Bashkia e Tiranës

Bashkia e Tiranës përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh me status të veçantë. Organet e Bashkisë e Tiranës janë: a) Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues i Bashkisë. b) Kryetari i Bashkisë si organi ekzekutiv i Bashkisë. Këshilli Bashkiak dhe Kryetari zgjidhen drejtpërdrejt nga populli me zgjedhje të drejtpërdrejta.

Këshilli Bashkiak dhe Kryetari gëzojnë të drejtat, kryejnë funksione dhe i ushtrojnë përgjegjësitë e përcaktuara për bashkitë në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Në Bashkinë e Tiranës funksionojnë 11 njësi bashkiake të qeverisjes vendore, të cilat kanë statusin e përcaktuar. Në njësinë bashkiake, organet përfaqësuese janë: a) Këshilli i njësisë bashkiake si organ përfaqësues i njësisë bashkiake. b) Kryetari si organ ekzekutiv i njësisë bashkiake. Organet e njësisë bashkiake zgjidhen përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Numri i anëtarëve të këshillit të njësisë bashkiake përcaktohet nga Prefekti në varësi të numrit të banorëve, në bazë të të dhënave të zyrove përkatëse të gjendjes civile (deri në 30 000 banorë 19 anëtarë nga 30 000 në 50 000 banorë 23 anëtarë mbi 50 000 banorë 27 anëtarë)

Njësia bashkiake miraton, zbaton dhe administron buxhetin e vet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Buxheti i njësisë bashkiake krijohet nga të ardhurat e veta dhe nga pjesa që financohet nga buxheti i Bashkisë së Tiranës, sipas përcaktimit që bën Këshilli Bashkiak. Të ardhurat e

61 Ligji për Qytetin e Shkupit. Burim: <http://mls.gov.mk/images/laës/Ligji%20per%20qytetin%20e%20Shkupit.pdf> (Qasur me: 28 qershor 2021)

veta sigurohen nga tarifat e shërbimeve që kryen njësia për funksionet që ka, sipas niveleve të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, nga dhuratat, ndihmat, gjobat e të tjera, të përcaktuara në ligjin përkatës. Fondet e kushtëzuara nga Bashkia u caktohen njësive bashkiake në përputhje me funksionet, të drejtat dhe detyrat që i jepen njësisë bashkiake, si dhe për plotësimin e funksioneve dhe të përgjegjësive të deleguara nga Këshilli Bashkiak.

Këshilli i njësisë bashkiake organizon kontrollin e brendshëm financiar. Çdo njësi bashkiake i nënshtrohet kontrollit të Bashkisë së Tiranës dhe kontrollit të jashtëm financiar, sipas rregullave të përcaktuara me ligj. Këshilli i njësisë bashkiake ka këto të drejta dhe detyra: a) Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet. b) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e këshillit. c) Emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit. ç) Miraton buxhetin e njësisë bashkiake dhe ndryshimet e tij, etj.

Kryetari i njësisë bashkiake ka këto detyra dhe përgjegjësi: a) Zbaton aktet e këshillit të njësisë bashkiake. b) Merr masa për përgatitjen e mbledhjes së këshillit në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë. c) Raporton në këshill për gjendjen ekonomike e financiare sa herë kërkohet nga këshilli, por jo më rrallë se një herë në 6 muaj. ç) Raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për problemet që kanë të bëjnë me kompetencat dhe detyrat e njësisë. d) Emëron dhe shkarkon zëvendëskryetarin e njësisë bashkiake. dh) Emëron dhe shkarkon personelin e administratës së vet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. e) Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar njësisë bashkiake, etj⁶²

62 Ligji Nr.8654, datë 31.7.2000 Për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë së Tiranës. Burim: <https://portavendore.al/ep-content/uploads/2018/04/LIGJI-8654-DATE-31.7.2000-PER-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-BASHKISE-SE-TIRANES-1.pdf> (Qasur me: 1 korrik 2021)

6

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIMET

Tri viteve pas miratimit të Ligjit për Kryeqytetin, Prishtina vazhdon të përballet me probleme të ndryshme. Edhe disa kompetenca apo të drejta që ky Ligj ka paraparë t'i ketë Prishtina, vazhdojnë të ngecin në zbatim. Kryeqyteti vazhdon të mos ketë Drejtori të veçantë policore, ndonëse ligji e ka paraparë. Poashtu veprimet në konkretizimin e nismave që Prishtina të bëhet me spital të veçantë komunal kanë ngecur dhe nuk ka ndonjë planifikim se kur do të fillojnë punimet për ndërtimin e këtij spitali në Prishtinë.

Përmbajtja aktuale e Ligjit për Kryeqytetin nuk e bejnë Prishtinën 'njësi të veçantë' të qeverisjes lokale në Kosovë. Janë disa kompetenca të veçanta (si drejtorja e veçantë e policisë për kryeqytetin, e drejta për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale, emerimi i një nënkryetari shtesë, emertimi i pozitave në kabinetin e kryetarit, taksa shtesë për Kryeqytetin).

Ligji për Kryeqytetin në shumë nene përsëritë të drejtat që i ka pasur Komuna e Prishtinës edhe me Ligjin për Veteqeverisje lokale, apo në ligjet e tjera sektoriale. Ligji për Kryeqytetin flet për Kuvendin e Kryeqytetit, për Kryetarin e Kryeqytetit, për komitetet obligative, për raportet me nivelin qendror, të cilat edhe me herët kanë qenë të rregulluara dhe të saktësuara me Ligjet e tjera në fushën e qeverisjes lokale.

Disa nene të këtij Ligji nuk janë saktësuar plotësisht dhe kjo ka krijuar paqartësi, vështirësi por edhe dykuptimësi. Neni i cili kërkon që prona e Komunës së Prishtinës të kthehet dhe regjistrohet si pronë e kryeqytetit i takon kësaj natyre. Poashtu kërkesa e Ligjit që Prishtina të ketë stemën, vulën dhe flamurin e saj, si dhe mundësinë që ka paraparë Ligji për dislokimin e disa shërbimeve të administratës të Bashkësive Lokale është konsideruar i vonshëm dhe i panevojshëm.

Nisur nga këto dhe të gjeturat e tjera të këtij hulumtimi dhe studimi rekomandohet:

Për Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal:

- Komisioni parlamentar duhet thërret në degjim publik Kryetarin e Prishtinës për të mësuar për detajet e zbatimit dhe mos zbatimit të Ligjit për Prishtinën. Të gjeturat nga ky diskutim duhet publikuar dhe dërguar deputetëve të Kuvendit të Kosovës.
- Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal duhet të përfshijë mbi baza vjetore vizitë në Komunën e Prishtinës për të parë nga afër zbatimin e Ligjit për Kryeqytetin dhe nevojat ligjore për plotësim ndryshim që dalin në këtë drejtim.

Për Ministrinë e Pushtetit Lokal:

- MAPL duhet të përfshijë në raportin vjetor “Funksionimi i Komunave të Kosovës” një seksion ndaras për Prishtinën duke u fokusuar në të drejtat që dalin nga Ligji për Kryeqytetin. Ministria e Pushtetit Lokal duhet të vendos në web faqe Ligjin për Kryeqytetin duke simbolizuar kështu rëndësinë e këtij Ligji në sistemin e përgjithshëm të qeverisjes lokale në Kosovë.
- MAPL poashtu duhet të shqyrtojë mënyrën e aplikimit të tasksës shtesë dhe të nxjerrë udhëzime shtesë për aplikimin e kësaj taske.

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme:

- Kjo Ministri duhet të formojë një grup punues në përbërje të së cilit duhet të jenë zyrtarë të Komunës së Prishtinës, zyrtarë të Ministrisë së Pushtetit Lokal, udhëheqës të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe përfaqësues nga shoqëria civile për t'i diskutuar dhe harmonizuar modalitetet e hartimit të udhëzimit administrativ që parasheh funksionalizimin e sektorit të policisë për Kryeqytetin.
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përfshijë në agjenden e saj legjislative finalizimin e udhëzimit administrativ për funksionalizimin e sektorit të policisë për Kryeqytetin.

Për Ministrinë e Shëndetësisë:

- Ministria e Shëndetësisë duhet të parasheh në buxhetin e saj edhe koston e participimit për të mundësuar dhe ndihmuar Prishtinën në funksionalizimin e shërbimit dytësor shëndetësor.

Për Komunën e Prishtinës:

- Komuna e Prishtinës duhet të caktojë dhe miratojë lokacionin për ndërtimin e spitalit të kryeqytetit.
- Komuna e Prishtinës duhet të nis dhe finalizojë studimin lidhur me ristrukturimin e sistemit shëndetësor në Kryeqytet duke përfshirë dhe paraparë ofrimin e shërbimit dytësor shëndetësor ashtu siç ka paraparë Ligji për Kryeqytetin.

- Komuna e Prishtinës duhet të përfshijë në buxhet shumen e nevojshme vjetore për ndërtimin/funksionalizimin e spitalit të Kryeqytetit.
- Komuna e Prishtinës duhet të publikojë mbi baza vjetore një raport të veçantë ku tregohen projektet e financuara nga të hyrat e mundësuar nga Ligji për Kryeqytetin.
- Komuna e Prishtinës brenda vitit 2021 duhet të finalizojë një studim se për cilat raste/fusha mund të angazhohet Policia e Kryeqytetit.

Bibliografia

- Dogana e Kosovës. Kërkesë për qasje në të dhëna publike. Adriatik Stavileci. Datë 26.04.2021
- Intervistë me Abdurrahman Krasniqin, shef i kabinetit të kryetarit të komunës së Obiliqit.
- Intervistë me Avni Zuka. Shef i personelit në Komunën e Prishtinës.
- Intervistë me Nënkryetarin e Komunës së Prishtinës Muhedin Nushi.
- Intervistë me Sadri Rrmoku, Koordinator i Prpgrameve në Institutin Kosovar për Qeverisje Lokale.
- Intervistë me Shkelqim Jakupi, Drejtor i Drejtorisë Ligjore në Ministrinë e Pushtetit Lokal.
- Intervistë Sadri Rrmoku, kordinatorë i projekteve në Institutin Kosovar për Qeverisje Lokale.
- Komuna e Prishtinës. Prishtina Online. Qyteti. Burim: <https://prishtinaonline.com/qyteti>
- Komuna e Prishtinës. Prishtina Online. Statuti i Komunës së Prishtinës, 2010. Burim: <https://www.prishtinaonline.com/uploads/statuti-i-komunes-se-prishtines-2010.pdf>
- Komuna e Prishtinës. Prishtina Open Data. Lista e Kryetarëve dhe anëtarëve të Bashkësive Lokale në Prishtinë. Burim: <https://bit.ly/3feK0lc>
- Komuna e Prishtinës. Rubrika lajmet. 2014. Burim: <https://bit.ly/3hUv9o7>
- Law of the Republic of Croatia on the Capital City of Zagreb 2001. Burim: <https://www.legislationline.org/documents/id/5864>
- Ligji Nr. 03/L-040. Qershor 2008. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3npm2ëi>
- Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3hDSXg2>
- Ligji Nr. 04/L-066. Qendrën Historike të Prizrenit. Korrik 2012. Burim: <https://bit.ly/3ukeT3e>
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë. Neni 7. Burim: <https://bit.ly/3f13gsA>
- Ligji nr. 04/L-076. Mars 2021. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/32R4obp>
- Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Maj 2013 Burim: <https://bit.ly/3frz9tv>
- Ligji Nr. 04/L-62. Për fshatin Hoçë e Madhe. Korrik 2012. Burim: <https://bit.ly/3unuEGs> dhe Ligji Ligji NR. 04/L-196. Zym i Hasit. Burim: <https://bit.ly/3ejil33>

- Ligji Nr. 05/L-044. Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij. Dhjetor 2016. Burim: <https://bit.ly/33hdnCV>
- Ligji Nr. 06/L-012. Qershor 2018. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3tEvB8C>
- Ligji Nr. 06/L-092. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës. Prill 2019. Burim: <https://bit.ly/3ububX6>
- Ligji për Organizimin dhe Funksonimin e Bashkësisë së Tiranës 2000. Burim: <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/04/LIGJI-8654-DATE-31.7.2000-PER-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-BASHKISE-SE-TIRANES-1.pdf>
- Ligji për Qytetin e Shkupit. Burim: <http://mls.gov.mk/images/laës/Ligji%20per%20qytetin%20e%20Shkupit.pdf>
- Policia Bashkiake. Ligji nr.8224 datë 15.05.1997 “për policinë bashkiake në Shqipëri”. Burim: <https://bit.ly/2RLx0Rr>
- Portali Shtetëror i Kosovës. Institucionet shëndetësore në territorin e Kosovës. Lista. Burim: <https://bit.ly/3u03MMë>
- Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave dhe Transfereve. Qarkorja buxhetore 2020 – 2021. Burim: <https://bit.ly/3h1vC7y>
- Qeveria e Kosovës. Ministria e Financës, Punës dhe Transfereve. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Vjetari Statistikor I Republikës së Kosovës 2021. Burim: <https://ask.rks-gov.net/media/6114/vjetari-statistikor-2021f.pdf>
- Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 –2025. Burim: <https://bit.ly/3oKĚJFO>
- Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë. 2016. Burim: <https://bit.ly/3bSF21X>
- Rregullorja Rregullore Nr.02/2013 mbi Kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrja e Komunave në bordet e drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të ujit. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Burim: <https://bit.ly/3uĚGAzk>
- Televizioni “Kohavision”. Intervistë e Kryetarit të Prishtinës Shpend Ahmeti. Minuta 3:05. Titulli i kronikës: Prishtina pa polici komunale, tri vite pas miratimit të Ligjit për kryeqytetin. Datë 4 prill 2021. Burim: <https://bit.ly/2QMF5VM>
- Televizioni “Kohavision”. Titulli i kronikës: Prishtina pa spital kërkon mosmbyllje të shërbimeve në QKUK. Datë 19.03.2021. Burim: <https://bit.ly/3ehPphd>
- The Congress of Local and Regional Authorities. Chamber of Local Authorities. Status of capital cities, 2007. Burim: <https://rm.coe.int/status-of-capital-cities/16807199af>
- The Constitution of Berlin of 23 November 1995, as amended as of March 2016. Burim: <https://www.berlin.de/rbmskzl/en/the-governing-mayor/the-constitution-of-berlin/>
- Zyra Kombëtare e Auditimit. Zbatimi i rekomandimeve të raportit “Fondi Zhvillimor” dhe efektet e fondit. Burim: <https://bit.ly/3nME5N8>

LIGJI PËR PRISHTINËN, TRI VITE PAS MIRATIMIT
(NIVELI I ZBATIMIT DHE EFEKTET E ARRITURA)

